

PROJEKT MARRËVESHJE BASHKIMI ME PËRTHITHJE

Ndërmjet

SHOQËRISE

“TV KLAN” sh.a

(shoqëria përthithëse)

dhe

SHOQËRISE

“TNSH” sh.p.k.

(shoqëria e përthithur)

I. DEKLARATË PARAPRAKE:

Sot më datë 25/05/2018 z. Aleksander FRANGAJ, në statusin e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “**Tv Klan**” **sh.a.**, me detyrën e ngarkuar nga Asambleja e Ortakeve të shoqërisë “**TV KLAN** ” **sh.a.**, referuar Vendimit datë 25/05 /2018, paraqet këtë **Projekt Marrëveshje për Bashkimin me Përthithje të dy shoqërive:**

Shoqërisë “**TV KLAN** ” **sh.p.k.**, me Nipt J71413001L rregjistruar si person juridik, me formën ligjore SH.A. në regjistrin tregtar në datë 12/02/1997. Kapitali i rregjistruar është 1,502,796,247 lekë dhe zotërohet nga Aksonieret e shoqërisë z. Aleksander FRANGAJ (njëkohësisht Administrator) dhe Zj. Alba GINA. Shoqëria e ka vendndodhjen e saj në adresën: Rr. “Aleksander Moisiu ,ish,Kinostudio”, Tiranë, Shqipëri (që më poshtë do të quhet **shoqëria Përthithëse**)

Dhe

Shoqërisë “**TNSH** ” **sh.p.k.**, me Nipt **K724070110** rregjistruar si person juridik, me formën ligjore sh.p.k. në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit në datë 22/06/2015. Kapitali i regjistruar është **100,000** lekë, dhe zotërohet nga Ortaku i vetëm Alba GINA. Shoqëria “**TNSH** ” ka administrator Zj. Alba GINA. Shoqëria e ka vendndodhjen e saj në adresën: Rr. “Aleksander Moisiu ,ish,Kinostudio”, Tiranë, Shqipëri (që më poshtë do të quhet **shoqëria e Përthithur**).

Këtu e më poshtë shoqëria “**TV KLAN** ” **sh.p.k.** dhe shoqëria “**TNSH** ” **sh.p.k.** janë quajtur individualisht **Pala** dhe bashkërisht **Palët**.

Shoqëria “**TV KLAN** ” **sh.a** dhe shoqëria “**TNSH** ” **sh.p.k.** janë dy shoqëri që me ane të kesaj projekt marrëveshje “**TNSH** ” **sh.p.k.** dhe shoqëria “**TV KLAN** ” **sh.a** do të integrohen në një person juridik të vetëm (Transaksioni i Bashkimit me përthithje).

Qëllimi është rritja e rendimentit në aktivitetin ekonomik të të njëjtes fushe dhe përfitimi nga bashkëveprimi, me qëllim uljen e kostove, rritjen e përfitimeve, uljen e konkurrencës si dhe pozicionim më i fortë në treg.

Në datën 25/05/2018, Asambleja e aksionereve të shoqërisë “**TV KLAN** ” **sh.a** vendosi fillimin e procedurave të transaksionit të bashkimit me përthithje. Deri në fund të këtij bashkimi shoqëria do të jetë

në një periudhë tranzitore. Gjatë kësaj periudhe do të ndërmerren hapa drejt bashkimit të strukturës së burimeve njerëzore si dhe konsolidimit të manaxhimit.


(Vendimin e asamblesë datë 25/05/2018 të shoqërisë “**TV KLAN ” sh.a.** e gjeni bashkëngjitur kësaj Projekt Marrëveshje).

Në datën 25/05/2018 Asambleja e Ortakut të shoqërisë “**TNSH ” sh.p.k.** vendosi fillimin e procedurave të transaksionit të bashkimit me perthithje me shoqërinë “**TV KLAN ” sh.a** dhe deri në fund të këtij bashkimi, shoqëria do të jetë në një periudhë tranzitore. Gjatë kësaj periudhe do të ndërmerren hapa drejt bashkimit të strukturës së burimeve njerëzore si dhe konsolidimit të manaxhimit.

(Vendimin e asamblesë datë 25/05/2018 të shoqërisë “**TNSH ” sh.p.k.** e gjeni bashkëngjitur kësaj Projekt Marrëveshje).

Në datën 25/05/2018 Asambleja e Aksionereve të shoqërive “**TV KLAN ” sh.a dhe Asambleja e Ortakut te vetem “TNSH ” shpk,** vendosën fillimin e procedurave të transaksionit të bashkimit me perthithje dhe kanë vendosur që përfaqësuesit ligjor të po këtyre shoqërive Z. Aleksander FRANGAJ dhe Zj. Alba GINA, të hartojnë këtë Projekt-Marrëveshje Bashkimi.

(Vendimet e asambleve datë 25/05/2018 të shoqërive i gjeni bashkëngjitur kësaj Projekt Marrëveshje).



II. PROJEKT MARRËVESHJE E BASHKIMIT TË DY SHOQËRIVE ME PËRTHITHJE

1. Shoqëria “TNSH ” sh.p.k. do të përthithet nga shoqëria “TV KLAN ” sh.a. sipas kushteve të kësaj projekt marreveshje.
2. Bazuar në Nenin 215 paragrafi 1 të Ligjit për “Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” do të transferojë më anë të Bashkimit me Përthithje të gjithë aktivet dhe pasivet që zotëron. Bazuar në nenin 220, paragrafi 3 pika “e” të Ligjit për “Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ekzistenca e shoqërisë “TNSH ” sh.p.k. do të vlerësohet e prishur dhe shoqëria “TV KLAN ” sh.a do të jetë shoqëria përthithëse dhe do të vazhdojë të ketë emrin e saj tregtar. duke iu referuar dt 31.12.2017
3. Shpenzimet në lidhje me negociimet, zbatimin dhe mbylljen e çdo dokumenti të nevojshëm për Përthithjen do të merren përsipër nga shoqëria “TV KLAN ” sh.a

Bilancet në mbyllje, data e ekzekutimit

1. Përthithja do të kryhet në datën e regjistrimit të Bashkimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe do të quhet data e ekzekutimit.
2. Bashkimi me Përthithje do të bazohet në bilancet e shoqërive me datë mbyllje 31.12.2017
3. Bilanci i hapjes së shoqërisë së përthithur në datën e ekzekutimit do të bazohet në bilancin e konsoliduar të dy shoqërive në datën 31.12.2017 dhe do të jetë bilanci i hapjes së shoqërisë përthithëse “TV KLAN ” sh.a. ne daten e miratimit te procedures se perthithjes do te behet dhe shkeputja e aktivitetit tatimor .

✓ Aktivet dhe Pasivet e transferuara

1. Në përputhje me nenin 215 të ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, shoqëria “TNSH ” sh.p.k. do të transferojë në shoqërinë “TV KLAN ” sh.a të gjithë aktivet materiale dhe jo materiale si dhe çdo të drejtë dhe detyrim tregtar me të tretë. Gjithashtu do te shoqeria klan do te ndjek edhe ndrrimin e titujve te pronesisë ne zyren e ZRPP
2. Aktivet e të dyja shoqërive do të jenë vlerësuar me vlerën kontabël të tyre në datën e mbylljes së bilanceve.
3. Shoqëritë do të vlerësojnë inventarët me vlerën kontabël të tyre në datën e mbylljes së bilanceve. dat 31.12.2017
4. Do të quhen aktive apo pasive të transferuara cdo markë, patentë, por jo duke u kufizuar vetëm në to, që shoqëria “TNSH ” sh.p.k. zotëron.

5. Kontrata me klientë, furnitorë apo debitorë kreditorë të tjerë të shoqërisë “TNSH ” sh.p.k. do të transferohen te shoqëria përthithëse.

6. Listat e të drejtave dhe detyrimeve të mundshme dhe lista e konflikteve të pazgjidhura do të jenë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

7. Nëse pas transferimit të aktiveve nevojitet miratimi nga ana e ndonjë kreditori ose palë të treta, shoqëritë që marrin pjesë në këtë proces do të bëjnë të mundur marrjen e këtij miratimi.

✓ **Hartimi i marrëveshjes së bashkimit me perthithje**

1. Për hartimin dhe realizimin e Aktit të Bashkimit të shoqërive me anë të Përthithjes, autorizohen **Përfaqësuesit Ligjorë.**

✓ **Raporti i këmbimit të kuotave.**

1. Raporti i këmbimit të kuotave do të bazohet në Ligjin për “Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe llogaritja e kuotave për secilin ortak do të bëhet nga Eksperti kontabel Znj Sanije Tafa në aksione.

2. Fitimet/humbjet e mbartura dhe ato të vitit ushtrimor do të mbarten si të tilla në bilancin e konsoliduar pas Bashkimit me Përthithje.

✓ **Statuti i shoqërisë përthithëse**

1. Statuti i shoqërisë “TV KLAN ” sh.a i ndryshuar në lidhje me përthithjen i cili do të miratohet në mbyllje do të konsiderohet Statuti i Shoqërisë Përthithëse që është shoqëria Tv Klan Sha aty do të ndryshoj vetëm kapitali i shoqërisë në kohën e depozitimit të procedurës.

✓ **Mbrojtja e kreditorëve**

1. Kreditorët e shoqërisë së përthithur “TNSH ” sh.p.k. mbrohen në përputhje me Nenin 221 të Ligjit për “Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

✓ **Pasojat për të punësuarit**

1. Pasojat e përthithjes në lidhje me të punësuarit do të përcaktohen nga Kodi i Punës pikërisht neni 138 dhe neni 139. te punësuarit transferohen në shoqërinë përthithëse

2. Në datën e ekzekutimit, çdo kontratë pune individuale që është në fuqi do të transferohet nga shoqëria e përthithur tek shoqëria përthithëse në përputhje me nenin 138 të Kodit të Punës.

3. Puna e kryer në shoqërinë “TNSH ” sh.p.k. do të njihet si punë e kryer tek shoqëria përthithëse dhe do të përfitojnë nga të gjitha të drejtat që përmbajnë kontratat e punës.

4. Shoqëria "TV KLAN" sh.a. do të konsiderohet përgjegjës për çdo detyrim - duke përfshirë detyrimet e papërbushura që rrjedhin nga transferimi i kontratave të punës.
5. Në bazë të nenit 138 paragrafi 3 njoftimi i pushimit nga puna për shkak të Bashkimit me Përthithje nuk lejohet. Zgjidhja e kontratës së punës për shkaqe të tjera pranohet.



✓ **Zgjidhja e marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje mund të zgjidhet në çdo kohë përpara Datës së Mbylljes me miratimin e dhënë me shkrim nga të dyja Palët.

Kjo Projekt Marrëveshje do të hartohet nga Administratoret e shoqërive "TV KLAN" sh.a Dhe "TNSH" sh.p.k.

Për "TV KLAN" sh.a

Aleksander FRANGAJ



"TNSH" sh.p.k.

Alba GINA



